



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 13851/2 prot.

Lezhë, më: 23-07-2026

RELACION
PËR SHPJEGIMIN E PROCEDURËS SË DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT
PYJOR KOMBËTAR, SHOQËRISË “F K ENERGY” SH.P.K, PËR VENDOSJEN E
ANTENËS PËR MATJEN E REZULTATEVE TË ERËS NË MALIN E RRENCIT
NJËSIA, ADMINISTRATIVE SHËNGJIN DHE PËR VENDOSJEN E ANTENËS PËR
MATJEN E REZULTATEVE TË ERËS NË MALIN E KAKARRIQIT, NJËSIA
ADMINISTRATIVE BALLDRE, BASHKIA LEZHË

Shoqëria **F K ENERGY” SH.P.K** ka paraqitur kërkesën e datës 05.05.2026 pranë Bashkisë Lezhë, për marrjen toke me qira për matjen dhe mbledhjen e të dhënave për erën për një periudhë minimale prej 12 muajsh, me qëllim instalimin e dy antenave meteorologjike me lartësi 120 metra në zonën e Malit të Rrencit dhe Malit të Kakarriqit, brenda territorit pyjor të Bashkisë Lezhë.

Bazuar në ligjin 57/2020 datë 30.4.2020 “Për Pyjet”, si dhe në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, kërkesa i drejtohet Këshillit Bashkiak për miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore për vendosjen e antenave për matjen e rezultateve të erës në Malin e Rrencit, Njësia Administrative Shëngjin dhe në Malin e Kakarriqit Njësia Administrative Balldre Bashkia Lezhë.

Bashkia Lezhë ka hapur shpalljen me numër 12078 prot datë 22.06.2026 për matjen e shpejtësisë e të drejtimit të erës si dhe për vendosjen e pajisjeve matëse për një periudhë të caktuar kohore 1-2 vite.

Shoqëria **F K ENERGY” SH.P.K** ka shprehur interesin dhe ka dorëzuar dokumentacionin përkatës brenda afateve të shpalljes, bashkangjitur letrës së interesit të datës 03.07.2026.

Nëpërmjet këtij studimi, Bashkia Lezhë synon që të grumbullojë të dhëna që lidhen me shpejtesinë e erës, drejtimin e saj, temperaturën, presionin atmosferik si dhe përcaktimin nëse këto zona janë potencial për ushtrimin e aktiviteve eolike. Shpejtësia e erës do të analizohet si faktor klimatik zhvillues dhe kufizues për bimësinë pyjore. Temperatura do të shërbejë për përzgjedhjen e llojeve bimore pyjore rezistente ndaj thatësirave dhe temperaturave ekstreme që vijnë si rezultat i ndryshimeve klimatike. Drejtimi i erës do të shërbejë për të gjitha operacionet e fikjes dhe izolimit të plotë të zjarreve në fondin pyjor. Për këto raste është shumë e rëndësishme që të kemi informacionin e saktë të drejtimit të erës në mënyrë që të bëhet orientimi i duhur i Shërbimit Zjarrëfikës me synim rritjen e efijencës në fikjen e zjarrit në një

kohë sa me të shkurtër duke evituar dëme në fondin pyjor dhe precipitimin e situatave në katastrofa natyrore.

Në këto raste, sipas VKM-së së sipërcituar nuk bëhet heqje nga fondi pyjor, por për efekt kadastral bëhet vetëm pakësimi në volum i materialit drusor që pritet në sipërfaqen që vendosen antenat që në rastin tonë nuk kemi të bëjmë me germim të sipërfaqes së tokës dhe prerjes së bimësisë, por thjesht bëhet montimi i antenave mbi sipërfaqe dhe fiksimi i tyre nëpërmjet kavove metalike. Gjithashtu segmentet e rrugës që do të përdorë, janë rrugë ekzistuese dhe do ti jepen në përdorim për të kryer aktivitetin për periudhën 1 vjeçare.

Në këto kushte, bazuar në ligjin numër 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", ligjin numër 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM-në numër 888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", bazuar në letrën e interesit të paraqitur nga shoqëria **F K ENERGY** SH.P.K për marrje toke pyjore në përdorim, i propozojmë Këshillit Bashkiak të shprehë miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **2 ha** dhe segmentin rrugor ekzistues prej **2.4km** në Ekonominë Pyjore Mali i Kakarriqit dhe miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **2 ha** dhe segmentin rrugor ekzistues prej **4.2km** në Ekonominë Pyjore Mali i Rrencit , për vendosjen e antenave për matjen shpejtësisë, drejtimit të erës, si dhe sensorë shtesë për temperaturën dhe presionin atmosferik.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, presim miratimin e projekt-vendimit.

Hartoi relacionin
Ing. Artan PALUSHI

DREJTORI
Paulin GJERGJI
NË MUNGESË DHE ME URDHËR
Alda PRENDI

KRYETARI
Pjerin NDREU

